



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal  
01 Nr.06-19566/1  
Dt.26.11.2015  
D r a g a s h

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash, në seancën e dt.26.11.2015, Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, miraton këtë:

## V E N D I M

- I. **THEMELOHET** Komisioni Komunal i Dragashit për vendosjen e kontakteve me Komisionin e dy ministrive (MAPL-së dhe MMPH-së) lidhur me Shkresën-Raportin Nr.0204-1109/5 të dt.27.07.2015 e Komisionit për rishqyrtim të ligjmërisë së vendimeve për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla..., në këtë përbërje 5-anëtarsh:
1. Halim Shemsidini, LDK,
  2. Vehbi Nazifi, PDK,
  3. Luljete Berisha, AAK,
  4. Hilmi Dauti, zyrtar ligjor i Komunës-Dragash, dhe
  5. Bean Haxhihasan, drejtor i Drejtratis të Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Planifikimit i Komunës-Dragash.
- II. Detyrë e Komisionit është që të vendos kontaktet me Komisionit e lartpërmendur të ministrive lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve kontestuese dhe ndërmarrjen e hapave të mëtejme të Kuvendit Komunal-Dragash dhe investuesëve që kanë paraqitur kërkesa.
- III. Për veprimet e ndërmarra të njoftohet Kuvendi Komunal-Dragash i cili do të shqyrton propozimet në njerën nga seancat e saj, duke miratur edhe Vendimin përkatës..

I dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit...,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi, dhe
- Arkivit

Kryesuesi i KK-së Dragash  
**Shaban Shabani**  
  
